



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 815/3 prot

Elbasan, më 28.03.2024

VENDIM

Nr 33, datë 28.03.2024

Për

trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2023-2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," i ndryshuar, VBA nr 35 datë 06.11.2023 "Për ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave: për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2023-2024", Relacionit "Për trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2023-2024", paraqitur nga Administratori z. Eljan Hoxha, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë bursë financiare 6 studentë me kriterë të tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 12 studentë me kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Nuk përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 1 student, sipas listës bashkëlidhur.
- 4- Për rastet që mund të evidentohen ndryshime në statusin e tyre apo të mosplotësimit të kriterëve të studentëve sipas listës në pikën 1, 2 dhe 3, të mos zbatohet vendimarrja e përfitimit, ndërsa ndryshimet në rastet e përfitimit të listës së pikës 4 të paraqiten për vendimarrje në BA.
- 5- Të evidentohen nga komisioni rastet e studentëve me status të pandryshuar; jetimë, i verbër, tetraplegjikë, paraplegjikë, fëmijë i policit të vrarë, romë egjiptian, të cilët kanë studiuar në ciklin e parë në UE dhe kanë përfutuar bursë apo përjashtim nga tarifa vjetore

- e shkollimit, por nuk kanë paraqitur kërkesë deri në periudhën që shqyrtohet, si dhe rastet e paidentuara të studentëve me rezultate (mesatare 9-10-të) dhe të relatohen në Bordin e Administrimit për përfitim bursë apo përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit
- 6- Vendimarrja të zbatohet pas konfirmimit të statusit të studentëve.
 - 7- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durmishi

